

K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE

"SUN AVENUE " shpk .

E lidhur sot me date 16 nentor 2017, ndermjet paleve :

1. REFAT SALI i biri i Veip dhe i Tati , dtl 26.08.1959 , lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane ne adresen rruga Naim Frasheri , nd 24, hyrja 3, ap 1, njesia bashkiake nr 7 , kodi postar 1023, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me identitetin e te cilit u garantova me karten e identitetit nr F90826091J.

2.SABINA SALI e bija e Refat dhe e Xhuljeta , dtl 14.12.1990 , lindur ne Vlore dhe banuese ne Tirane ne adresen rruga Naim Frasheri , nd 24, hyrja 3, ap 1, njesia bashkiake nr 7, kodi postar 1023, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar ,shtetase shqiptare ,me identitetin e te ciles u garantova me karten e re te identitetit nr J06214069E .

Te dy palet duke qene te pranishem, te deklaruar ortake rane dakord qe kontraten e themelimit te shoqerise se perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" nr 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare Te Regjistrimit " , dhe vendosen sa me poshte:

NENI 1

Te krijojne shoqerine tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar " **SUN AVENUE** " sh.p.k., e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin bashkengjitur kesaj kontrate, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

Kjo shoqeri do te emertohet " **SUN AVENUE** " sh.p.k.


NENI 2

Shoqeria " **SUN AVENUE** " sh.p.k. do te kete Qendren ne Tirane , njesia bashkiake nr 7 , rruga Naim Frasheri , nd 24, hyrja 8, ap 4, kodi postar 1023, , dhe do te ushtroje veprimtarine e saj private per nje periudhe kohore mbi 10 vjet, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e :

- *Prodhimi energjise elektrike duke shfrytezuar burimet e energjise te cilat gjenden ne natyre dhe jane te rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e eres, gjeotermale, e biomases ose biogazit si dhe energjia nga mbetjet urbane.*



- *Prodhimin dhe tregtimin me shumice e pakice te energjise elektrike.*
- *Te Import – eksportit dhe tregtimit me shumice dhe pakice , te artikuljeve te ndryshem , industrial ,bujqesor , blektoral, ushqimor , materiale te ndertimit , inerteve, te konfeksioneve , parkete e mokete, paisje zyresh , duralumini, metaleve , hidrosanitare , elektro shtepiake, elektronike, kondicioner . elektrike dhe hidraulike .*
- *Ndertime civile – industriale-turistike-bujqesore .*
- *Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe per te trete.*

NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin, seline, kohezgjatjen, pjesemarrjen e kuotave, objektin e veprimtarise se saj, me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaket rane dakord te bashkojne kapitalet e tyre me qellim persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise. Kapitali themeltar i shoqerise do te jete: 1.000.000 leke te reja (njemilon) dhe eshte ndare midis te 2 ortakeve me kontributet si me poshte vijon :

- 1.Refat Sali me 1 kuote e barabarte me 60 % te kapitalit me vlere (600.000 leke)
- 2.Sabina Sali me 1 kuote e barabarte me 40 % te kapitalit me vlere (400. 000 leke)

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht, pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.


NENI 6

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket, por ne asnje rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortaket e tjere te rrisin kuoten e tyre ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te percaktojne kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku qe ka ndermend t'u shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht, duhet te njoftoje me pare ortaket e tjere te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit. Per hollesi te metejshme ortaket do ti referohen dispozitave te parashikuara ne Ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" nr 9901 date 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori ose Administratoret.

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

NENI 9

Ortaket themelues te Shoqerise kane zgjedhur si administratore te shoqerise zonjen XHULJETA SALI e bija e Omer dhe e Sara , dtl 16.02.1966, lindur ne Vlore dhe banuese ne Tirane , me karten e re te identitetit nr G65216073U . Administratorja zgjidhet per 5 vjet kohe me te drejte ripertesitje .

NENI 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme ne se jane miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave te Ligjit Per Shoqerite Tregtare ne lidhje me pjesmarrjen dhe shumicen e votave sipas kuotave ne kapitalin themeltar per Asamblene. Menyra e thirrjes se Asamblese , kompetencave te ortakeve dhe marrjes se vendimeve do te bazohet ne statutin e shoqerise si dhe ne Ligjin "Per shoqerite tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese.

Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i secilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera financiare, te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

NENI 12


Fitimi neto i realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

NENI 13

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 14

Ortakët jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiencës se shkëmbyer, te realizuar brenda veprimtarise te shoqerise.



NENI 15

Te gjitha mosmareveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidatore sipas normave ligjore.

NENI 17

Kjo kontrate u perpilua ne prani te tre ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire dhe te plote te tyre.


NENI 18


Kontrata u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne Q.K.R, tatime, zyren e noterise si dhe nje kopje ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaket themelues , autorizojne administratoren e shoqerise zonjen Xhuljeta Sali per te kryer veprimet perkatese per regjistrimin e kesaj shoqerie si person juridik prane Q.K.R-se

PER SHOQERINE " SUN AVENUE " SH. P. K

O R T A K E T

1. *Bexat Sali* 

2. *Sabina Sali* 

dt 16/11/2017